



UNIVERSITETI I PRISHTINËS
"HASAN PRISHTINA"
UNIVERSITY OF PRISHTINA

Rr. Xhorxh Bush, Ndërtesa e Rektoratit, 10 000 Prishtinë, Republika e Kosovës
Tel: +381 38 244 183 • E-mail: rektorati@uni-pr.edu • www.uni-pr.edu

Rektor
Prof. Dr. Marjan DEMA

Nr. Prot.: 3/228
Datë: 27/10/2016

Senati i Universitetit të Prishtinës, në mbledhjen e XII-të të mbajtur më datën 14.10.2016, mori

V E N D I M

- I. Lejohet vazhdimi i kohëzgjatjes së studimeve/diplomimit për studentët e vitit të fundit në nivelin bachelor të studimeve në njësitë akademike të Universitetit të Prishtinës të cilët nuk kanë arritur që ti përfundojnë studimet në periudhën e dyfishtë të kohëzgjatjes së studimeve dhe që kanë arritur numrin maksimal të regjistrimit të serishëm të viteve pa i përfunduar me sukses studimet.
- II. Vazhdimi i kohëzgjatjes për përfundimin e studimeve për studentët si në pikën I të këtij vendimi, lejohet përfundimisht deri më 30.9.2017.
- III. Studentët të cilët nuk arrijnë që brenda periudhës së lejuar sipas pikës II të këtij vendimi të përfundojnë studimet (diplomojnë), me kërkesë të veçantë drejtuar komisionit të studimeve të njësisë përkatëse akademike duhet ti nënshtrohen ndryshimit të programit dhe provimeve diferenciale të cilat i cakton ai komision.
- IV. Ky vendim hyn në fuqi nga dita e miratimit në Senat.

Arsyetim

Senati pasi shqyrtojë me kujdes kërkesën e njësive akademike dhe studentëve për lejimin e vazhimit të kohëzgjatjes së studimeve/diplomimit për studentët e vitit të fundit në nivelin bachelor të studimeve në njësitë akademike të Universitetit të Prishtinës, të cilët kanë kaluar periudhën e dyfishtë të kohëzgjatjes së studimeve dhe që kanë arritur numrin maksimal të regjistrimit të serishëm të viteve pa i përfunduar me sukses studimet e konsideroj si të arsyeshme kërkesën, prandaj vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi t'i dërgohet:

1. Arkivit të UP-së;
2. Dekanëve të njësive akademike;
3. Sekretarëve të njësive akademike;
4. Sekretarit të përgjithshëm të UP-së;
5. Për publikim në ueb-faqe.

REKTORI

Prof. Dr. Marjan Dema

